



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:187195
Datë: 08.03.2024
Numri i dokumentit: 05426644

AA.nr.647/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi, kryetar, Delushe Halimi dhe Hajriz Hoti, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Besarta Sopaj, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses S.K, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit av. Naim Kurtishi, nga Prizreni, kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur sipas ankesës së paditëses, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1923/2021, të datës 12.07.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 05.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditëses S.K nga Prizreni, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1923/2021, i datës 12.07.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1923/2021, të datës 12.07.2023, në pikën I të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses S.K, me të cilën ka kërkuar që të anulohet aktvendimi i të paditurës Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Pensioneve i datës 08.06.2021 dhe që paditëses ti njihet e drejta në pension familjar. Ndërsa në pikën II të dispozitivit është vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë përfaqësuesi i autorizuar i paditëses, avokat Naim Kurtishi, për shkak të: shkeljes së dispozitave ligjore procedurale, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimi të gabuar të ligjit material-

ashtu siç rrjedh nga përmbajtja e ankesës. Me propozim që të anulohet vendimi i atakuar me ankesë.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, dhe pas vlerësimit të aktvendimit të kundërshtuar si në vështrim të nenit 49 të LKA-së dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), ka gjetur se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, me vendimin e datës 08.06.2021, nën pikën I të dispozitivit e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e znj. S.K nga Prizreni, me numër të ID-së:... për njohjen e të drejtës në pension Familjarë.

Paditësja e pakënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 24.08.2021, me pretendim se i njëjti është i padrejtë dhe i kundërligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditëses e refuzon si të pabazuar. Me arsyetim se nga vendimin i kontestuar i datës 08.06.2021 gjykata e shkallës së parë ka vërejtur se edhe pas kthimit të çështjes në rivendosje te e paditura, e njëjta serish kishte refuzuar ankesën e paditëses S.K për njohjen e të drejtës në pension familjar, me arsyetimin se nuk janë përmbush kriteret ligjore të parapara me nenin 12 të Ligjit Nr.04 / L- 131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti. Paditësja e pakënaqur me këtë vendim, me datë 24.08.2021, sërish ka parashtruar padi përmes së cilës ka kontestuar ligjshmërinë e tij. Kështu për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të goditur, gjykata e shkallës së parë i'u referua dispozitës së nenit 3 paragrafi 1.9, si dhe nenit 12 të Ligjit Nr. 04/L-13 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti. Nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata e shkallës së parë ka vërejtur se bashkëshorti i paditëses i ndjeri B.K ka qenë në marrëdhënie pune në Ndërmarrjen Ushqimore "P...". Mirëpo nga Libreza e punës dhe me nr.13796 dhe letërkonfirmim i datës 25.01.2018 është vërtetuar se i ndjeri kishte stazh pune jo më shumë se 12 vite e një muaj e 19 ditë, që do të thotë se paditësja nuk kishte dëshmuar se i siguruari, në këtë rast i ndjeri-bashkëshorti i saj kishte 15 vite stazh pensional dhe njëherit ti ketë paguar kontributet për 15 vite stazh pensional. Më pas paditësja nëpërmes ankesës së saj të datës 30.01.2018, pretendonte se bashkëshorti i saj i ndjerë ka vdekur me datë 04.08.2000 si pasojë e lëndimit në punë, konkretisht sipas saj: "gjatë punës në komorën e akulloreve është pickuar nga bleta, i cili pickim i ka shkaktuar alergji dhe derisa ka arrit në spital nga puna në ora 09.00 të mëngjesit ka ndërruar jetë", dhe në vërtetim të saj kishte përmendur vërtetimin për të ndjerin të lëshuar nga dr. C.M. Prandaj gjykata e shkallës së parë me qëllim të vërtetimit të këtij pretendimi, shqyrtoi provën në fjalë e cila nuk është paraqitur e plotë, megjithatë përmes të njëjtës nuk u vërtetua se paditësi ka vdekur si pasojë e lëndimit në vendin e tij të punës. Prandaj gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se organet administrative drejtë kanë zbatuar dispozitën e

nenit 12 të paragrafi 1,2,3 dhe 4 të Ligjit nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuar nga Shteti, në bazë të të cilit edhe është refuzuar kërkesa e paditëses për njohjen e të drejtës në Pension Familjar. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar edhe pretendimet tjera të paditëses dhe ka gjetur se të njëjtat në këtë çështje administrative, nuk kanë ndikim në vendosje tjetër, nga ajo që ka vendosur organi i paditur, sepse me provat e administruara, në kuptim të dispozitës së cekur ligjore, është vërtetuar se paditësja nuk i plotëson kushtet ligjore për njohjen e të drejtës së kërkuar. Nga kjo, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se aktvendimi kontestues, është i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe se organi i paditur, drejtë ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar ligjin material, kur ka refuzuar ankesën e paditëses dhe ka vërtetuar vendimin e organit të shkallës së parë. Mbi këto arsye kërkesëpadinë e paditëses nuk e aprovoi, sepse sipas vlerësimit të gjykatës, nuk është cenuar ligji në dëm të paditëses.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 43 par.3 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të pretendimeve në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë i'u ka referuar dispozitës së nenit 3 paragrafi 1.9 të Ligjit Nr. 04/L-13 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, me të cilin është përcaktuar që *"Pensioni familjar- është pensioni i rregullt mujor i paguar për anëtarët e familjes në rast të vdekjes së të punësuarit, që ka qenë në marrëdhënie pune, të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me këtë ligj"*, dhe nenit 12 paragrafi 1 të po këtij ligji, në të cilin është përcaktuar që: *"Të drejtën për pension familjar e realizojnë të gjithë ish shfrytëzuesit e pensionit familjar të cilët janë nën moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare dhe të cilët realizimin e kësaj të drejte e dëshmojnë me Vendim apo fletëpagesë të pensionit që tregon se kanë qenë shfrytëzues të pensionit familjar, para datës 01.01.1999, sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr.011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83). Ndërsa paragrafi 2 parasheh që " Sipas paragrafit 1 të këtij neni, të drejtën në pension familjar e realizojnë, anëtarët e ngushtë të familjes, të ish të siguruarit që ka vdekur pas datës 01.01.1999, të cilët dëshmojnë se i siguruari ka paguar për pesëmbëdhjetë (15) vite kontributet për stazhin pensional", ndërsa paragrafi 3 përcakton :*"Të drejtën në pension familjar e realizojnë anëtarët e familjes të të punësuarit/ës, që kanë vdekur pas vitit 01.01.1999, si pasojë e lëndimit në punë ose sëmundjes profesionale, pa marrë parasysh kohëzgjatjen e stazhit të punës"*. Dhe në fund paragrafi 4 përcakton se *"Të drejtën në pension familjar, sipas paragrafit 2 dhe 3 të këtij neni, e realizojnë: 4.1. bashkëshorti/ja, deri në moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç, që dëshmojnë se janë në kurorë si dhe nuk janë në marrëdhënie pune ose të vetëpunësuar; 4.2. Bashkëshorti/ja, nën moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare, i shpallur invalid i përhershëm dhe i pa aftë për punë; 4.3. fëmijët deri në moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare përkatësisht njëzet e gjashtë (26) vjeçare, nëse ofrojnë dëshmi përkatëse për vijimin e shkollimit të rregullt universitar. "**

Sa i përket pretendimeve ankimore të përfaqësuesit të autorizuar të paditëses, se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave procedurale, këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, ngase aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, e as me shkelje të tjera të cilat do të ndikonin në ligjshmërinë e aktgjykimit të ankimuar. Meqë gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancat dhe seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së aktgjykimit të ankimuar në mënyrë të gabuar ka vërtetuar gjendjen faktike sepse i autorizuari i palës paditëse Av. Naim Kurtishi, paraprakisht në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me parashtrese të shkruar e të dërguar përmes rrugës postare qysh me datën 01.07.2023 me të cilën Gjykatën e çështjes e ka njoftuar se për arsye objektive, nga fakti se paraprakisht i autorizuari av.Naim Kurtishi ka qenë i thirrur për të prezentuar në Gjykatën Themelore në Prizren me një lëndë tjetër atë C.Nr.68/20 shqyrtim për të cilin ka qenë i caktuar për datën 12.07.2023 dhe se në këtë parashtresë është dhënë arsyetimi se nuk kemi patur mundësi për të prezentuar në këtë seancë të datës 12.07.2023 në lëndën A-1923/21 dhe kemi kërkuar shtyrjen e kësaj seance për një afat tjetër kohorë. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate vlerëson se janë të pa bazuara, ngase me dispozitën e nenit 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative përcaktohet se *“1. Mungesa e palës në shqyrtimin verbal nuk e pezullon punën e gjykatës. 2. Për shkak të mungesës së palëve nuk mund të konstatohet se ato kanë hequr dorë nga kërkesat e tyre, por do të lexohen parashtresat e tyre. 3. Nëse në shqyrtim nuk vjen as paditësi dhe as pala e paditur, ndërsa shqyrtimi nuk shtyhet, gjykata do të shqyrtojë konfliktin edhe pa praninë e palëve.”*. Po ashtu gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditëses, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditëses janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, ngase të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, meqë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe të gjitha së bashku, me të drejtë ka ardhur në përfundim se e paditura pasi që ka shqyrtuar pretendimet e ankesës së ankuesit-tani paditëses, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, drejtë ka zhvilluar procedurën në këtë çështje juridike-administrative, si dhe drejtë ka zbatuar të drejtën materiale. Andaj, pranë një gjendje të tillë faktike, kolegji i kësaj gjykate konsideron se aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi

Kurse, sa i përket pretendimeve tjera ankimore se gjykata e shkallës së parë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, gabimisht ka zbatuar edhe të drejtën materiale, ky kolegji nuk i aprovoj, sepse vlerësoj se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të paargumentuara me prova konkrete të cilat do të gjenin mbështetje ligjore, dhe si të tilla janë pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë

është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, ankesa e paditëses u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditëses, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura të njëpasnjëshme një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditëses u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

AA.nr.647/2023 me datë 05.03.2024

Kryetari i kolegjit,
Ramiz Kuqi